



PRANUAR MË:

ACCEPTED ON: 30.12.2022

PRIMLJENO:

Nr.No.Br.

02/649



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS

Kryesuesi i Kuvendit

Nr.02/

Datë: 04.01.2023

Në bazë të nenit 11 dhe nenit 12 paragrafi 2 shkronja (c), nenit 17 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Gazeta e Republikës së Kosovës, nr.28, dt.04 06.2008, Statutin e Komunës së Malishevës, Statutit të Komunës së Malishevës nr.01/871 datë:12.11.2008, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e dhjetë (X) të rregullt e thirrur me datë:28.12.2022 dhe e të mbajtur me datë: 30.12.2022 merr këtë:

V E N D I M

Neni 1.

Miratohet, draft-Plani i Integritetit për Komunën e Malishevës për vitet 2022-2025.

Neni 2.

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është, edhe Plani i Integritetit për Komunën e Malishevës dhe përfshinë vitet 2022-2025.

Neni 3.

Për zbatimin e këtij Vendimi, do të kujdeset Kryetari i Komunës, përmes drejtorëve të drejtorive të Komunës së Malishevës.

Neni 4.

6.Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës ky vendim hynë në fuqi sipas nenit 81 të Ligjit nr03/040, për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe në pajtim me nenin 8 dhe 9 të Rregullores (QRK) Nr.06.2021 dhe pas shpalljes në ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet :

1.MAPL-së

2.Arkivit të Komunës



Kryesuesi i Kuvendit
Argjend Thaci

Neni 5.

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës ky vendim hynë në fuqi sipas nenit 81 të Ligjit nr03/040, për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe në pajtim me nenin 8 dhe 9 të Rregullores (QRK) Nr.06.2021 dhe pas shpalljes ne ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet :

1.MAPL-së

2.Arkivit të Komunës

Kryesuesi i Kuvendit

Argjend Thaçi



PRANUAR MË:

ACCEPTED ON:

PRIMLJENO:

Nr.No.Bi,

16/12/2022

03/454



REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA E MALISHEVËS

Malishevë, 16.12.2022

RAPORTI VJETOR I PLANIT TË INTEGRITETIT



zbatuar, duke identifikuar rreziqet, planifikimin dhe zbatimin e masave adekuate, të cilat forcojnë integritetin dhe kulturën kundër-korrupsion në punën e organeve të administratës komunale.

❖ Hyrje

Në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe “Strategjinë Shtetërore Kundër Korrupsionit” të cilat obligojnë të gjitha institucionet të zhvillojnë dhe miratojnë planet e integritetit, dhe raportin njëherë në vit ku, përmes verifikimit dhe raportit të integritetit të Komunës i dokumenton dhe vlerëson nivelin e cënueshmërisë së Komunës dhe ekspozimin e tyre ndaj praktikave jo etike dhe të korrupsionit. Plani rritet përkushtimin e Komunës së Malishevës për të shtuar dhe fuqizuar kontrollet ekzistuese operative në të gjitha aktivitetet, duke u fokusuar në ofrimin e shërbimeve efikase, transparente dhe të orientuar kah qytetari dhe të komunikimit të brendshëm përmes hartimit të raportit ku rekomandohen edhe masat e bazuara në rrezik për arritjen e objektivave të Komunës sidhe forcimin e sundimit të ligjit, vlerave e standardet profesionale.

❖ Raporti i Integritetit është bazuar në Planin e Integritetit dhe të objektivave dhe kemi këto të arritura apo frenime të fenomeneve negative të cila zbehin dhe sanksionojnë komunën.

- Rritjen e mundësive që Komuna të arrijë objektivat e saja organizative, duke vënë përpara një menaxhim proaktiv të rrezikut të integritetit. Kjo do të përmirësojë rezistencën organizative ndaj korrupsionit dhe do të zvogëlojë mundësitë për korrupsion;
- ❖ Përqendrimin te prioritetet, në bazë të identifikimit dhe vlerësimit të rrezikut që do ta ndihmojnë komunën të shpërndajë në mënyrë efektive burimet e disponueshme kundër korrupsionit, që të shfrytëzohen në mënyrën më mirë të mundshme;
- ❖ Përmirësimin e kontrolleve operacionale ndaj shkeljeve të integritetit që do të rrisin efektivitetin, efikasitetin dhe transparencën e të gjitha proceseve, përfshirë ofrimin e shërbimeve për qytetarët;
- ❖ Mbajtjen e një sistemi për të siguruar pajtueshmërinë me kërkesat dhe standardet ligjore dhe procedurale;
- ❖ Krijimin e një mjedisi të brendshëm të favorshëm kundër korrupsionit përmes trajnimit të synuar dhe ndërgjegjësimit, si dhe duke inkurajuar një bashkëpërgjegjësi të të gjithë stafit në procesin e zhvillimit, zbatimit dhe monitorimit të planeve të integritetit;

- **Auditimi i Brendshëm;**

Në bazë të planit të vet vjetor si sektor i auditimit ka planin, raportin dhe të gjeturat gjatë auditimit të brendshëm dhe rekomandimeve të Auditorit gjeneral apo të jashtëm, kërkohet edhe më shumë efikasitet në auditim të drejtorive dhe sektorëve komunal.

- **Prokurimi publik;**

Ka zbatuar planin vjetor dhe ka publikuar në Eprokurimi si dhe në Webfaqe të komunës , kontratat e të gjitha natyrave duke i respektuar procedurat e bazuar në udhëzime administrative.

- **Burimet njerëzore**

Ka përmbushur planin e punës dhe ka zbatuar obligimet e detyruar sipas përgjegjësisë që ngarkohet, procesi ku kërkohet angazhim është konkurset sipas procedurave apo hapave në rekrutim i brendshëm, lëvizje brenda kategorisë, i jashtëm, përmes SIMBNJ, trajnimet e punëtorëve për ti rritur kapacitete profesionale si dhe informacione brenda sektorit që udhëheqin.

- **Avokati i Komunës**

Azhuriteti në mbrojtjen e të drejtës komunale ka treguar rritje por ndihet nevojë e reformimit të infrastrukturës ligjore në nivel qëndror përball komunave pasi po dëmtohen këto të fundit nga kërkesat përmes përmbaruesve, ku në forma të ndryshme shtrojnë qytetarët apo institucionet publike.

- **Drejtoria për Ekonomi dhe Financë-Zhvillimi Ekonomik Lokal**

Plani, Buxheti, raportet financiare tremujore dhe vjetore dëshmojnë efikasitet në shpenzimin e parasë publike në investimet kapitale dhe infrastrukturë e cila ndikon në mirëqenie të qytetarëve.

- **Planifikimi urban, rural dhe Standardet e ndërtimit dhe kontrolli;**

Kompliksiteti i kësaj drejtorie ka treguar se vetëm me profesionalizëm dhe mbikqyrje poashtu profesional rritë standardet e cilësisë dhe përmes kontrollit e sanksioneve ndaj atyre të cilët nuk zbatojnë kriteret e kontratës në punët që marrin përmes ofertës si punktyerës.

- **Integrimet evropiane**

Nga ky sektorë kërkohet azhurnimi dhe implementimi i më shumë standardeve të integruar në nivel lokal e të cilat ndihmojnë në avancim dhe imazh pozitiv të komunës dhe qytetarëve tanë.

- **Të drejtat e njeriut dhe barazia gjinore**

Me gjithë angazhimin e zyrtarës për barazi gjinore e cila mbulon edhe të drejtat e fëmijëve dhe të grave, dokumenteve që ka në zbatim lenë shumë për të dëshiruar kjo fushë pasi ka nevojë edhe

Ka subvencionuar OJQ-të sipas thirrjes publike dhe ka ndihmuar në zyrtarizimin e KVRL-së si dhe Qendrës Rinore, përrurime librash,aktivitet të natyrave me të rinjët , si trajnime, pajisje të biblioteksë së qyteti, muzeu i qytetit dhe aseteve të trashëgimisë kulturore, shpirtërore dhe natyrore.

- **Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural;**

Ka zhvillime pozitive në subevencionim të fermerve të komunsë son që nga mjetet e punës, serrave, blegtorëve, qumshtarëve, bletarëve, pemëtarëve dhe degëve tjera në bujqësinë e komunës sonë.

- **Mbrojtje dhe shpëtim**

Ka treguar azhuritet në menaxhim të situatave emergjente si domos të vërshimeve gjatë këtij viti kalendarik, me të gjitha kapacitete e resurset me të cila posedon si në burime njerëzore dhe mjete të motorizuara.

Koordinatori i Zbatimit të Planit të Integritetit

Fatmir Ademaj

